

EDU, CORRUPTION SCAN



HULUMTIM I OPINIONIT PUBLIK

Perceptimi, njohuritë dhe
përvojat e të rinjve në
fushën e korrupsionit në
sistemin e edukimit

2016

HULUMTIM I OPINIONIT PUBLIK:

Perceptimi, njohuritë dhe përvojat e të rinjve në fushën e korrupsionit
në sistemin e edukimit

“Ky hulumtim u mundësua nga Programi i Angazhimit për Barazi (E4E), i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC. Përmbytja është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC, USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara”.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	7
Hyrje	12
Metodologjia	14
Faza 1 – Faza përgatitore	14
Faza 2 – Mbledhja e të dhënave	15
Faza 3 – Futja e të dhënave, hedhja në tabelë dhe analizimi	15
Profili i respondentëve	16
Nxënësit	16
Studentët	16
Rezultatet	20
Problemet e përgjithshme në Kosovë	26
Problemet në sistemin e edukimit	26
Korrupsioni në sistemin e edukimit	31
Mekanizmat për luftimin e korrupsionit	50
Konkluzionet	60
Shtojca I – mostra finale e target grupeve të intervistuar	61
Falënderime	63
Rreth Lëvizjes Fol	64

LISTA E FIGURAVE

- Figura 1. Mësimdhënësit - ndarja sipas gjinisë.
- Figura 2. Mësimdhënësit - niveli akademik.
- Figura 3. Mësimdhënësit - vendi ku jep mësim.
- Figura 4. Nxënësit- ndarja sipas gjinisë.
- Figura 5. Nxënësit - shkolla ku ndjekin mësim.
- Figura 6. Nxënësit - klasa në të cilën vijojnë mësimet.
- Figura 7. Studentët - gjinia.
- Figura 8. Studentët - fakulteti ku vijojnë mësimet.
- Figura 9. Studentët - viti i studimeve.
- Figura 10. Mësimdhënësit - tre problemet kryesore në Kosovë.
- Figura 11. Nxënësit - tre problemet kryesore në Kosovë.
- Figura 12. Studentët - tre problemet kryesore në Kosovë.
- Figura 13. Mësimdhënësit - a pajtoheni me këto dy deklaratat?
- Figura 14. Nxënësit - a pajtoheni me këto dy deklaratat?
- Figura 15. Studentët - a pajtoheni me këto dy deklaratat?
- Figura 16. Mësimdhënësit - sa jeni të kënaqur me sistemin arsimor?
- Figura 17. Nxënësit - sa jeni të kënaqur me sistemin arsimor?
- Figura 18. Studentët - sa jeni të kënaqur me sistemin arsimor?
- Figura 19. Mësimdhënësit - sipas mendimit tuaj, cila është gjendja aktuale e etikës dhe përgjegjshmërisë në sistemin e edukimit në Kosovë?
- Figura 20. Nxënësit - sipas mendimit tuaj, cila është gjendja aktuale e etikës dhe përgjegjshmërisë në sistemin e edukimit në Kosovë?
- Figura 21. Studentët - sipas mendimit tuaj, cila është gjendja aktuale e etikës dhe përgjegjshmërisë në sistemin e edukimit në Kosovë?
- Figura 22. Mësimdhënësit - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.
- Figura 23. Nxënësit - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.
- Figura 24. - Studentët - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.
- Figura 25. Mësimdhënësit - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.
- Figura 26. Nxënësit - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.
- Figura 27. Studentët - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.
- Figura 28. Mësimdhënësit - a pajtoheni me këto deklaratat?
- Figura 29. Nxënësit - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.
- Figura 30. Studentët - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.

Figura 31. Mësimdhënësit - sa është i përhapur korrupsioni në Kosovë?

Figura 32. Mësimdhënësit - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.

Figura 33. Mësimdhënësit - a është rritur korrupsioni në Kosovë?

Figura 34. Mësimdhënësit - a do të rritet niveli i korrupsionit në sistemin e edukimit në Kosovë?

Figura 35. Mësimdhënësit - niveli i korrupsionit i projekteve të ndërtimeve dhe furnizimit me blerje për shkollat.

Figura 36. Mësimdhënësit - niveli i korrupsionit - vlerësimet edukative.

Figura 37. Mësimdhënësit - pranimi i nxënësve në shkollë.

Figura 38. Mësimdhënësit - niveli i korrupsionit - rritja e numrit të mësimdhënësve dhe promovimi i kuadrove në shkollë.

Figura 39. Mësimdhënësit - niveli i korrupsionit - notimi i nxënësve dhe zgjedhja e nxënësve më të mirë.

Figura 40. Mësimdhënësit - cilët udhëheqës komunalë janë më të korruptuar?

Figura 41. Mësimdhënësit - cilët udhëheqës të shkollës janë të korruptuar?

Figura 42. Mësimdhënësit - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.

Figura 43. Nxënësit - a keni shfrytëzuar lidhjet personale për të arritur avantazhe në shkollë?

Figura 44. Studentët - a keni shfrytëzuar lidhjet personale për të arritur avantazhe në shkollë?

Figura 45. Nxënësit - a janë normale sjellje të tilla korruptive?

Figura 46. Studentët - a janë normale sjellje të tilla korruptive?

Figura 47. Nxënësit - a keni paguar ryshfet për të përmirësuar notat?

Figura 48. Studentët - a keni paguar ryshfet për të përmirësuar notat?

Figura 49. Nxënësit - a keni paguar për t'u pranuar në shkollë?

Figura 50. Studentët - a keni paguar për t'u pranuar në shkollë?

Figura 51. Nxënësit - a keni paguar për t'iu shmangur/zbutur masat disiplinore?

Figura 52. Studentët - A keni paguar për t'iu shmangur/zbutur masat disiplinore?

Figura 53. Nxënësit - a janë normale sjelljet e tilla korruptive?

Figura 54. Studentët - a janë normale sjelljet e tilla korruptive?

Figura 55. Nxënësit - a është rritur niveli i korrupsionit në sistemin e edukimit?

Figura 56. Studentët - a është rritur niveli i korrupsionit në sistemin e edukimit?

Figura 57. Mësimdhënësit - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.

Figura 58. Mësimdhënësit - sa efektive janë mekanizmat që i aplikojnë shkollat për promovimin e etikës, përgjegjshmërisë dhe luftës kundër korrupsionit?

Figura 59. Nxënësit - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.

Figura 60. Studentët - a pajtoheni me këto deklaratat? Vlerëso prej 1 deri 5 ku 1=aspak nuk pajtohem dhe 5=plotësisht pajtohem.

Figura 61. Nxënësit - sa efektive janë mekanizmat që i aplikon shkolla për promovimin e etikës, përgjegjshmërisë dhe luftës kundër korrupsionit?

Figura 62. Studentët - Sa efektive janë mekanizmat që i aplikon shkolla për promovimin e etikës, përgjegjshmërisë dhe luftës kundër korrupsionit?

Figura 63. Mësimdhënësit - gjatë viteve të fundit autoritet publike vendore a kanë zbatuar politika apo masa efektive kundër korrupsionit në sistemin e edukimit?

Figura 64. Nxënësit - gjatë viteve të fundit autoritet publike vendore a kanë zbatuar politika apo masa efektive kundër korrupsionit në sistemin e edukimit?

Figura 65. Studentët - gjatë viteve të fundit autoritet publike vendore a kanë zbatuar politika apo masa efektive kundër korrupsionit në sistemin e edukimit?

Figura 66. Mësimdhënësit - a pajtoheni me këto deklaratat? Rango prej 1 deri në 5 ku 1=aspak nuk pajtohem deri në 5=plotësisht pajtohem.

Figura 67. Mësimdhënësit - kur iu është dashtë herën e fundit të jepni para apo dhuratë shtesë në shkollën tuaj, a e keni paraqitur këtë para autoriteteve/institucioneve zyrtare?

Figura 68. Nxënësit - kur iu është dashtë herën e fundit të jepni para apo dhuratë shtesë në shkollën tuaj, a e keni paraqitur këtë para autoriteteve/institucioneve zyrtare?

Figura 69. Studentët - kur iu është dashtë herën e fundit të jepni para apo dhuratë shtesë në shkollën tuaj, a e keni paraqitur këtë para autoriteteve/institucioneve zyrtare?

Figura 70. Nxënësit - çfarë ka ndodhur pasi që e keni lajmëruar rastin?

Figura 71. Nxënësit - pse nuk e keni lajmëruar?

Figura 72. Studentët - pse nuk e keni lajmëruar?

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

5

Ky raport paraqet tërësinë e të dhënave të grumbulluara nga anketimi i bërë si pjesë e hulumtimit në 5 komuna të Kosovës, i cili ka bërë matjen rreth perceptimit, njohurive, përvojave në raport me korrupsionin në sistemin e edukimit.

Hulumtimi është inicuar nga Lëvizja FOL si një nevojë e domosdoshme për krijimin e pasqyrës së qartë të mendimit të të rinjve mbi këtë dukuri, një skanim i detajuar i qëndrimeve të tyre dhe përballjes me të njëjtën. Sa i përket periudhës kohore të zhvillimit të anketimeve me mostrat e përcaktuara paraprakisht pas analizimit për inkuadrimit të të rinjve në luftimin e korrupsionit, procesi është zhvilluar gjatë muajve Dhjetor 2015–Janar 2016.

Mostra e anketave të hulumtimit ishin mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të mesme të 5 komunave të Kosovës. Komunitat e përzgjedhura për të intervistuar mostrat e këtij hulumtimi janë: Prishtina, Ferizaj, Gjakova, Podujeva dhe Mitrovica e që janë të zgjedhura si komuna me numër më të madh të të rinjve, si mostër kyçe e tërë këtij hulumtimi.

Për të balancuar gjetjet konkretisht opinionin publik rreth perceptimit dhe njohurive për korrupsion, është menduar që të përfshihet edhe grupmosha më e madhe se e nxënësve të shkollave të mesme në mënyrë që tërësia e grupmoshave të të rinjve të prekin të gjitha kategoritë e moshave prej 16–21 vjeç.

Veç nxënësve të shkollave të mesme dhe mësimdhënësve, i është kushtuar rëndësi e veçantë studentëve, si një kategori e rëndësishme, formimi dhe edukimi i së cilës paraqet bazën e një strukture e cila do të jetë pjesë e shtet-ndërtimit në një kohë shumë të afërt.

Arsye tjetër e cila e ka bërë të domosdoshme përfshirjen e studentëve si mostër/cak i këtij hulumtimi është se janë më të informuar mbi pasojat negative që kjo dukuri shkakton në shoqëri dhe janë pikërisht në moshën më aktive e cila mundëson gjithpërfshirjen e tyre në aktivitete dhe inkuadrimit të drejtpërdrejtë e të vullnetshëm kur ata kanë njohuri të mjaftueshme. Poashtu rëndësi të veçantë i është kushtuar përfshirjes së studentëve pothuajse të të gjitha fakulteteve të Univeristetit të Prishtinës, duke e rritur kështu gjithpërfshirjen e tyre në nxjerrjen e opinionit publik rreth perceptimit dhe përvojave të tyre për korrupsionin në sistemin e edukimit.

Është praktikë e përgjithshme që për ekzistimin e një problemi, trajtimin e tij dhe për pasojat që shkakton problemi, informatat më të sakta dhe të

Komunitat e përzgjedhura për të intervistuar mostrat e këtij hulumtimi janë: Prishtina, Ferizaj, Gjakova, Podujeva dhe Mitrovica e që janë të zgjedhura si komuna me numër më të madh të të rinjve, si mostër kyçe e tërë këtij hulumtimi.

besueshme të nxirren nga vetë të prekurit e këtij problemi apo nga ata që janë në pozita nga të cilat mund të vërehen aktivitetet negative, ekzistimin apo mos-ekzistimin si dhe pasojat e shkaktuara nga këto probleme.

Papunësia,
korrupsioni dhe
varfëria u veçuan
si problemet më të
mëdha aktuale.

Pikërisht për të patur saktësinë dhe për të nxjerrë një opinion publik të besueshëm nga kategoritë që janë vetë pjesë e sistemit të edukimit, janë përzgjedhur këto tri kategori: nxënësit, mësimdhënësit dhe studentët. Qëllimi kryesor i anketimit ishte nxjerrja e perceptimit, njohurive dhe përvojave në raport me korrupsionin në sistemin e edukimit që njëherësh do të nxirrte edhe problemet më të mëdha, me të cilat po përballlet edukimi në Kosovë.

Të anketuarit janë pyetur për problemet e përgjithshme me të cilat Republika e Kosovës si një shtet relativisht i ri po ballafaqohet në këtë periudhë dhe nga përgjigjet e përgjithshme të nxjerra nga këto tria kategoritë e mostrës së përfshirë në hulumtim, mësimdhënësit, nxënësit dhe studentët u veçua papunësia, korrupsioni dhe varfëria si problemet më të mëdha aktuale.

Veç këtyre problemeve më madhore, janë theksuar edhe problemet e tjera nga respondentët e anketimit, të cilat i shqetësojnë ata dhe të cilat ndikojnë në jostabilitet të përgjithshëm në vend e këto janë: Qeveria e Kosovës, funksionimi i dobët i Sistemit të Drejtësisë dhe niveli i ulët i zhvillimit ekonomik.

Një çështje shumë kyçe e cila padyshim lidhet me shkallën e funksionalitetit të të gjitha shtyllave të pushtetit të ndarë në Republikën e Kosovës, është besimi qytetar në institucione.

Për të parë opinionin e këtyre kategorive të intervistuar mbi besueshmërinë që kanë në institucionet kyçe të vendit, funksionimin e tyre dhe mbi perceptimin e shkallës së korrupsionit në po këto institucione përmes pyetjeve të përfshira në pyetësor është kërkuar që respondentët të listojnë institucionet që besojnë se janë më të korruptuara. Nga rezultatet e nxjerra bazuar në përgjigjet e marra, repondentët si institucionet më të korruptuara në sistemin e Republikës së Kosovës kanë radhitur: Qeverinë e Kosovës, Prokuroritë, Gjykatat e Kosovës duke vijuar më tutje me Kuvendin e Kosovës, Partitë Politike, Universitetet Private dhe ato Publike.

Vështruar nga niveli i korrupsionit që respondentët besojnë se ka përfshirë institucionet tona shtetërore apo strukturat në përgjithësi të cilat u listuan më lartë, të njëjtit kanë radhitur edhe institucionet të cilat ata/ato besojnë se ka shkallë më të ulët të korrupsionit.

Si më pak të korruptuara nga përgjigjet e respondentëve rezultojnë të jenë: Administrata Shtetërore, Policia, Shkollat, Mediat dhe Organizatat Joqeveritare.

Meqenëse tërë hulumtimi si proces është inicuar duke patur fokus çështjen e sistemit të edukimit, të rinjtë dhe korrupsionin, ishte e domosdoshme që nga target grupet/mostrat të merren informata mbi nivelin e korrupsionit në institucionet arsimore, etikën e mësimitdhënësve, gjendjen aktuale me të cilën përballen nxënësit dhe mësimitdhënësit si dhe përvojat e tyre karshi këtyre dukurive negative shoqërore apo keqpërdorimet e mundshme në shkollat ku ata ndjekin mësimet/ ligjërojnë.

E gjetur e këtij hulumtimi është se nxënësit e intervistuar kanë vënë në pah që mësimitdhënësit e shkollave fillore, ofrojnë kurse jashtë shkollore për të cilat ata janë të detyruar të paguajnë kurse mësimitdhënësit për të njëjtën dukuri nuk janë pajtuar se është e pranishme, duke bërë që dy kategoritë respondente të ndeshen në përgjigje të kundërta me njëra-tjetrën për të njëjtën çështje.

Edukimi është njëra nga shtyllat e krijimit të një shoqërie të aftë sepse shkollat dhe universitetet si institucione kanë për qëllim ofrimin e njohurive edukuese, shkencore , ngritjen dhe aftësimin profesional të nxënësve dhe studentëve e të gjitha këto ndikojnë në formimin intelektual të të rinjve.

Marrja e ryshfetit, kërkimi i drejtëpërdrejtë apo i tërthortë i tij është vepër penale e paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe paraqet dukurinë në të cilën personi zyrtar kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, në mënyrë që personi zyrtar të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare.

Duke parë pikën kryesore mes edukimit të duhur dhe në shoqërinë e shëndoshë dhe me vlera, vërejmë se (shkollat dhe universitetet si institucione edukative kanë në kompetencë të tyre detyrat e dhënies së një edukimi të barabartë dhe sipas standardeve më të larta të etikës së punës dhe profesionalizmit) për rezultate të suksesshme duhet shmangur çdo dukuri negative që do të mund të interferonte në punën dhe mbarëvajtjen e proceseve edukative në Kosovë.

Për të vërejtur se a janë përballur me situata të tilla kur respondentët kanë dhënë/marrë ryshfet personave kompetent të fushës së arsimit, të njëjtit janë pyetur nëse dukuria e tillë është e pranishme dhe e zakonshme në institucionin ku punojnë/vijojnë. Nga të tria kategoritë e targetuara të këtij hulumtimi, është nxjerrë përgjigjia se në shkollat ku punojnë/vijojnë mësimit, nuk është e zakonshme që nxënësit t'iu japin ryshfet stafit menaxherial të shkollës me qëllim që t'i kryejnë punët në mënyrë efikase.

Për sa i përket nepotizmit si një dukuri negative e cila njihet si akti i të përdorurit të pushtetit apo influencës për të marrë punë të mira apo avantazhe të padrejta me qëllim që të përfitojnë anëtarët e familjes, respondentët e pyetur janë përgjigjur në përqindje më të madhe se deri diku, stafi menaxherial i shkollës i'u jep përparësi anëtarëve të familjeve, të afërme dhe miqve të tyre në rastin e pranimit të nxënësve në shkollë.

Ofrimi i shkollimit si e drejtë e barabartë për të gjithë fëmijët, është detyrim ligjor madje në Ligjin për Arsimin Parauniversitar i potencuar si obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, në mënyrë që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.

Ekzistimi i nepotizmit bënë që e drejta e garantuar me ligj për trajtim të barabartë të të gjithë fëmijëve/nxënësve të shkelet, me qëllim të avantazheve dhe përfitimeve familjare.

E gjetur tjetër ishte se respondentët kanë nxjerrë në pah se përveç nepotizmit, ka raste kur stafi menaxherial i shkollës, shfrytëzon edhe të mirat materiale të shkollës për përfitime personale.

Shikuar nga këndvështrimi i mësimdhënësve mbi ekzistimin e korrupsionit në vetë sistemin e edukimit, mësimdhënësit që i janë nënshtruar këtij hulumtimi mendojnë se kjo dukuri negative është e pranishme por nuk është në nivelet e larta sikurse në institucionet e tjera shtetërore.

Kryesisht është më lehtë që të intervistuarit të përgjigjen mbi ekzistimin e një dukurie apo jo, kur nuk përfshihet përvoja e tyre personale. Megjithatë qëllimi i këtij hulumtimi ishte nxjerrja e të dhënave pikërisht nga përvoja e vetë target grupeve dhe rezultati i intervistimeve nxjerr një numër shumë të vogël të atyre që kanë pranuar të kenë shfrytëzuar nepotizmin. Vetëm 4% e nxënësve dhe studentëve kanë pranuar që ata kanë shfrytëzuar lidhjet e tyre personale për të arritur avantazhe në shkollë, avantazhe këto që kryesisht mund të ishin me marrjen e një note pozitive që nuk e kanë merituar.

Se si dukuria e tillë perceptohet nga vetë nxënësit, a e vërejnë si diçka që drejtpërdrejtë ndikon në mosfunksionimin e të gjitha institucioneve në të cilat paraqitet, si duhet të trajtohet dhe në çfarë shkalle ekziston, ishin pyetjet për të cilat do të nxirreshin shpjegime nga vetë përgjigjet e target grupeve. Sipas nxënësve të përfshirë në këtë intervistim, një përqindje e konsiderueshme e tyre, sjelljet korruptive i konsiderojnë normale.

Nga praktika e përditshme është vërtetuar që luftimi i një dukurie të tillë negative nga cilido insitucion, përveç masave të marra për të ndëshkuar personat të cilët janë përfshirë në afera korruptive, janë të domosdoshme edhe fushatat senzibiliuese të cilat vetëdijësojnë dhe parandalojnë një dukuri të tillë. Meqenëse hulumtimi është bërë në sistemin e edukimit, është fare e qartë domosdoshmëria për aktivitete edukuese përmes të cilave do të rrënjosej ideja e shkaqeve të dëmshme që kjo dukuri sjell, nevojën për të mos bërë akte të tilla dhe promovimin e luftës kundrejt korrupsionit.

Të pyetur mbi institucionin ku ata punojnë/mësojnë, mësimsdhënësit, nxënësit dhe studentët janë të mendimit se shkollat aktivisht promovojnë masa kundër korrupsionit përmes organizimit të aktiviteteve sensibiliuese (ligjërata, aktivitete ekstra kurrikulare etj.).

Sa i përket masave të marra nga shkolla për luftimin e korrupsionit, të gjitha kategoritë janë të pajtimit se këto masa janë deri diku jo efektive.

Dukuria e pranimit të dhuratave, nëse analizohet në aspektin e pranimit të tyre nga personat zyrtar, një dukuri e tillë është e ndaluar kur ka të bëjë me ushtrimin e detyrave zyrtare në të cilat mund të ndikojë.

Një numër shumë i vogël i mësimsdhënësve, nxënësve dhe studentëve kanë pranuar që kanë dhënë apo marrë dhuratë. Të pyetur se a kanë denoncuar/lajmëruar rastin e tillë pranë institucioneve kompetente, prej tyre janë përgjigjur se e kanë lajmëruar Policinë e Kosovës dhe është filluar procedurë lidhur me rastin.

Meqenëse në Kosovë është praktikë e moslajmërimit të rasteve të tilla, ishte e domosdoshme që nga hulumtimi të nxirreshin arsyet që i bënin personat të cilët kanë hasur në raste të tilla të heshtnin dhe të mos i lajmërojnë të njëjtit. Nga tërësia e respondentëve që kanë theksuar se nuk e kanë lajmëruar fare rastin pranë ndonjë institucioni, si arsyet kryesore për heshtjen e tyre kanë theksuar këto; është praktikë e zakonshme të jepet para/dhuratë, frika nga pasojat, dobia nga dhurata e madje edhe kur personi ka dhënë dhuratë në shenjë falenderimi.

2. HYRJE

Republika e Kosovës, ndër vite si problem të vazhdueshëm ka pasur korrupsionin, një dukuri kjo e cila ndikon negativisht në funksionimin e duhur të institucioneve e mbi të gjitha në sundimin e ligjit, si kusht bazë i vendeve të zhvilluara dhe demokratike. Korrupsioni është hasur pothuajse në të gjitha nivelet e institucioneve, duke dëmtuar kështu vetë institucionet si shkak i përfitimeve personale të zyrtarëve të cilët nuk e kanë repektuar detyrën zyrtare ngase kanë vënë interesin personal mbi të gjitha.

Vetë dukuria si e tillë, është keqpërdorim i pushtetit apo çdo sjellje tjetër e personit zyrtar apo personit tjetër që për qëllim ka arritjen e përparësisë apo përfitim të kundërligjshëm për veten apo për tjetrin, është e tillë.

Në tërësi problemi me çështjen e korrupsionit nuk qëndron vetëm me ekzistimin e kësaj dukurie, por thellohet nga mos-trajtimi institucional i rasteve të paraqitura, fshehja e rasteve të tilla duke mos i lajmëruar pranë institucioneve dhe mungesa e aktiviteteve shumëdimensionale që do të sensibilizonin shtetasit e ndryshme të shoqërisë dhe do të mundësonin luftimin dhe parandalimin e kësaj dukurie. Kosova e radhitur si një nga shtetet me shkallë më të lartë të korrupsionit në rajonin e Ballkanit, është shtet i cili nuk ka arritur të luftojë këtë dukuri në mënyrë efikase.

Nëqoftëse analizohet çështja e korrupsionit në sistemin e edukimit, del në pah nevoja e domosdoshme për një trajtim më të thellë dhe për një gjithëpërfshirje të nxënësve dhe studentëve, si target grupet me të cilat duhet të punohet në mënyrë të vazhdueshme për të shmangur krijimin e një perceptimi që dukuria e korrupsionit është e pranueshme.

Pikërisht për të parë se si e kuptojnë korrupsionin, a e kanë hasur në shkolla, a njohin mekanizmat institucional për trajtim të tij, si kanë vepruar kur janë ndeshur me këtë dukuri dhe çfarë duhet të bëhet veçanërisht për të ngritur nivelin e vetëdijes të të rinjve në luftimin e korrupsionit, është inicuar ky hulumtim, si burim i të dhënave të nxjerra drejtëpërdrejtë nga këto kategori.

Inicimi i një hulumtimi të tillë veçanërisht është bërë për këto arsye:

- Për të përcaktuar perceptimet, njohuritë dhe përvojat e të të rinjve në raport me nivelin e korrupsionit në sistemin e edukimit në Kosovë.
- Për të nxitur aktivizimin qytetar tek të rinjtë në promovimin e luftës anti-korrupsion, në sistemin e edukimit përmes teknologjisë dhe medieve sociale.
- Për të fuqizuar rolin e të rinjve në promovimin e luftës anti-korrupsion, në sistemin e edukimit në Kosovë.
- Për të edukuar të rinjtë për institucionet dhe mekanizmat përgjegjës për luftimin e korrupsionit, në sistemin e edukimit të Kosovës.

Përfshirja e të rinjëve në këtë fushatë është më se e domosdoshme ngase përmes edukimit të tyre për shkaktarët dhe efektet e korrupsionit në sistemin e edukimit, do të ngrisim interesimin dhe aktivizimin e tyre në këtë luftë si dhe do të siguronim një të ardhme me një shoqëri me vlera e integritet moral e profesional.

Puna përgatitore dhe intervistimi/anketimi si pjesë e këtij hulumtimi, ka përfshirë hapat specifik të rrjedhës së procesit si në vijim:

- Punimi i metodologjisë të hulumtimit,
- Përcaktimi final i mostrës reprezentative në 5 Komuna,
- Zhvillimi dhe pilot testimi i pyetësorëve për studim,
- Krijimi dhe adaptimi i i aplikacionit (databazave) për përfshirje të të dhënave nga terreni,
- Përcaktimi i personelit profesional për ta udhëhequr punën në terren,
- Trajnimi i personelit të terrenit – mbikqyrësve dhe anketuesve,
- Realizimi i intervistave në terren,
- Përshtatja e aplikacioneve për përfshirje të të dhënave,
- Realizimi i kontrollës së terrenit dhe kontrollës logjike të pyetësorëve,
- Përfshirja e të dhënave dhe
- Analizimi i të dhënave.

3. METODOLOGJIA

Në lidhje me “Hulumtimin e Opinionit Publik rreth Perceptimit, Njohurive, Përvojave në Raport me Korrupsionin në Sistemin e Edukimit” është kryer një anketë, e cila është bërë përmes një metodologjie sasiore, ku për grumbullimin e të dhënave në terren janë angazhuar ekipet e UBO Consulting. Procesi i matjes së perceptimeve dhe marrjes së informatave relevante, është kryer në pajtim me standardet profesionale ndërkombëtare për metodologjitë sasiore të anketimit përfshirë edhe krijimin e miratimin e pyetësorit, mbledhjes dhe analizimit të të dhënave si dhe raportimin. Në mënyrë më specifike ky hulumtim është zbatuar përmes:

Anketimit sasior

400 intervista sasiore me nxënës të shkollave të mesme dhe profesionale,
100 intervista sasiore me mësimmshënës të shkollave të mesme dhe profesionale dhe
300 intervista sasiore me studentë të Universitetit të Prishtinës.

Sa i përket Hulumtimit i cili shfrytëzon Teknikat e Intervistimit fazat vijuese ishin kryer:

FAZA 1- FAZA PËRGATITORE

Finalizimi i pyetësorëve:

Gjatë krijimit të pyetësorëve kuantitativ dhe shfrytëzimit të intervistuesve për t'i administruar ata, i është kushtuar vëmendje e veçantë përdorimit të gjuhës së kuptueshme nga të anketuarit, shmangia e pyetjeve ndikuese për të mos sugjeruar fuqishëm një përgjigje të caktuar si dhe radhitjes logjike të tyre.

Angazhimi i ekipit të anketimit:

Është bërë rekrutimi i ekipit intervistues në përbërje prej 14 anketuesve, një mbikqyrës terreni, katër anëtarë personeli për përpunim dhe futje të të dhënave si dhe një koordinator i projektit, detyrë e të cilit ishte mbikqyrja e punës në terrenet e komunave të përzgjedhura për të qenë pjesë e këtij hulumtimi përmes anketimit.

Trajnimi i ekipit anketues: Të gjithë intervistuesit e rekrutuar, i janë nënshtruar fillimisht trajnimit për të qenë të gatshëm për fazën e intervistimit të target grupeve të anketimit. Qëllimi i këtij trajnimi ishte të sigurojë që: a) anketuesit t'i kuptojnë pyetjet e anketës tërësisht, b) anketuesit janë të informuar për metodologjinë e mostrave dhe intervistimit dhe c) anketuesit të jenë intervistues efektiv dhe të mund të administrojnë intervistat lehtë e me përpikmëri.

FAZA E DYTË

Mbledhja e të dhënave

Puna në terren: Puna në terren është kryer nga 1 Dhjetor 2015 deri më 14 Janar 2016.

Kontrollimet e cilësisë: Kjo ishte pjesë e pandashme e punës në terren. Kontrolli i cilësisë është përbërë nga:

Mbikëqyrësi i terrenit i cili ishte përgjegjës për të kryer kontrollin e parë të cilësisë duke ekzaminuar secilin pyetësor të dorëzuar.

Niveli i dytë i kontrollit të cilësisë ishte kryer nga personeli i futjes së të dhënave gjatë futjes së të dhënave në bazën elektronike të të dhënave.

FAZA E TRETË

Futja e të dhënave, hedhja në tabelë dhe analizimi

Futja dhe analizimi i të dhënave për pjesën sasiore të studimit është bërë në SPSS dhe tabelat ishin gjeneruar sipas planit të analizës e cila ishte finalizuar në konsultim me ekipin e shkrimit të raportit.

Pastrimi i të dhënave është një pjesë e rëndësishme e çfarëdo procesi i cili përfshin volum të madh të të dhënave. Profesionistët tanë me përvojë për pastrimin e të dhënave siguruan që të dhënat të mos përmbajnë çfarëdo kodesh, gabimesh, mos-pajtueshmëri të padëshiruara apo mungesë të dhënash.

Nxjerrja e cross-tabelave u gjeneruan për të zbuluar ndërlidhjen në mes të dhënave të bazuara në një numër të variablëve (atyre që janë relevante për objektivat e studimit).

PROFILI I RESPONDENTËVE

Mësimdhënësit

Gjatë fazës së intervistimit të mësimdhënësve, është praktikuar metoda e përzgjedhjes sistematike të rastit, më ç'rast janë intervistuar 100 mësimdhënës dhe ndarja gjinore e tyre është si më poshtë. Po ashtu në grafet e mëposhtme tregohet niveli akademik i përfunduar i mësimdhënësve (shkollë e lartë, fakultet apo magistraturë). Dhe së fundmi tregohet se ku është duke dhënë mësim momentalisht mësimdhënësi i intervistuar.

Nxënësit

Grafikonet e mëposhtme paraqesin ndarjen gjinore të nxënësve, institucionin ku vijojnë mësimin (Gjimnaz/Shkollë profesionale) si dhe klasën në të cilën janë duke vijuar mësimet.

Studentët

Edhe për studentët si kategori e tretë e përfshirë në mostrën e këtij hulumtimi, janë paraqitur grafikonet me të dhënat mbi gjininë, fakultetin në të cilin studiojnë dhe vitin e studimeve të cilin e ndjekin, për të pasur sa më të qartë karakteristikat specifike të këtyre respondentëve.

FIGURA 1
MËSIMDHËNËSIT - NDARJA SIPAS GJINISË



FIGURA 2
MËSIMDHËNËSIT - NIVELI AKADEMIK




FIGURA 3
MËSIMDHËNËSIT - VENDI KU JEP MËSIM

VENDI	PRISHTINË	MITROVICË	GJAKOVË	PODUJEVË	FERIZAJ
GJIMNAZ	24.3%	62.5%	46.7%	30%	27.3%
SHKOLLA PROFESIONALE	75.7%	37.5%	53.3%	70%	72.7%

FIGURA 4
NXËNËSIT- NDARJA SIPAS GJINISË



FIGURA 6
NXËNËSIT- KLASA NË TË CILËN VIJOJNË MËSIMET



FIGURA 5
NXËNËSIT - SHKOLLA KU NDJEKIN MËSIMET

VENDI	PRISHTINË	MITROVICË	GJAKOVË	PODUJEVË	FERIZAJ
GJIMNAZ	54%	50.9%	50%	39.6%	43.7%
SHKOLLA PROFESIONALE	46%	49.1%	50%	60.4%	56.3%

FIGURA 7
STUDENTËT - NDARJA SIPAS GJINISË



FIGURA 8
STUDENTËT - FAKULTETI KU VIJOJNË MËSIMET





FIGURA 9
STUDENTËT - VITI I STUDIMEVE



4. REZULTATET

4.1. PROBLEMET E PËRGJITHSHME NË KOSOVË

Të tria target grupet e respondentëve (mësimdhënësit, nxënësit dhe studentët) janë pyetur lidhur me problemet në përgjithësi me të cilat ballafaqohet Kosova dhe problemet që ata i vlerësojnë si më të rëndësishme në sistemin e edukimit në Kosovë si dhe për etikën në punë.

Në pyetjen se cilat janë tri problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet Kosova sot, mësimdhënësit nga komuna të ndryshme kanë zgjedhur opzione të ndryshme. Mësimdhënësit e Komunës së Ferizajt kanë zgjedhur funksionimin e dobët të Sistemit të Drejtësisë (50%), Varfërinë (50%) dhe nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik (40.9%) si tri problemet kryesore. Mësimdhënësit nga Komuna e Podujevës kanë zgjedhur korrupsionin (100%), papunësinë (60%) dhe varfërinë (30%).

Sa i përket mësimdhënësve nga Komuna e Gjakovës, korrupsioni (73.3%), papunësia (73.3%) dhe funksionimi i dobët i Sistemit të Drejtësisë (26.7%) kanë qenë tri opsionet më të zgjedhura. Mësimdhënësit nga Komuna e Mitrovicës kanë zgjedhur korrupsionin (56.3%), papunësinë (43.8%) dhe funksionimin e dobët të Sistemit Arsimit (31.3%). Ndërsa sa i përket Komunës së Prishtinës, mësimdhënësit kanë zgjedhur korrupsionin (81.1%), papunësinë (51.4%) dhe varfërinë (29.7%) si problemet më të rëndësishme me të cilat ballafaqohet Kosova.

FIGURA 10
MËSIMDHËNËSIT - TRE PROBLEMET KRYESORE NË KOSOVË

	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna
	Prishtinë	Mitrovicë	Gjakove	Podujeve	Ferizaj
Puna e Qeverisë së Kosovës	29.7%	75.0%	26.7%	40.0%	27.3%
Puna e Kuvendit të Kosovës	13.5%	12.5%	20.0%	20.0%	18.2%
Reformat e administratës publike			6.7%		
Korrupsioni	81.1%	56.3%	73.3%	100.0%	36.4%
Niveli u ulët i zhvillimit ekonomik	18.9%	25.0%	26.7%	10.0%	40.9%
Varfëria / Niveli i ulët i standardit të jetës	29.7%	25.0%	20.0%	30.0%	27.3%
Papunësia	51.4%	43.8%	73.3%	60.0%	50.0%
Funksionimi i dobët i sistemit të drejtësisë	24.3%	6.3%	26.7%	10.0%	50.0%
Funksionimi i dobët i sistemit shëndetësor	18.9%	12.5%	6.7%	20.0%	9.1%
Funksionimi i dobët i sistemit arsimor	21.6%	31.3%	6.7%	0.0%	13.6%
Kriminaliteti dhe pasiguria	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	13.6%
Procesi i njohjeve të Kosovës	0.0%	6.3%	6.7%	0.0%	0.0%
Procesi i Liberalizimit të Vizave	0.0%	6.3%	6.7%	10.0%	13.6%

69.4%

mesatarisht
mësimdhënësit
kanë thënë se
korrupsioni është
problemi kryesor
në Kosovë.

55.7%

mesatarisht
mësimdhënësit
kanë thënë se
papunësia është
problemi kryesor
në Kosovë.

39.7%

mesatarisht
mësimdhënësit
kanë thënë se
Puna e Qeverisë
së Kosovës është
problemi kryesor
në Kosovë.

Në të njejtën pyetje nxënësit e shkollave të mesme nga komuna të ndryshme kanë zgjedhur opsione të ndryshme. Nxënësit e Komunës së Ferizajt kanë zgjedhur papunësinë (75%), korrupsionin (56.3%) dhe punën e Qeverisë së Kosovës (28.8%) si tri problemet kryesore. Nxënësit nga Komuna e Podujevës kanë zgjedhur korrupsionin (60.4%), papunësinë (54.7%) dhe varfërinë (52.8%). Sa i përket nxënësve nga Komuna e Gjakovës, korrupsioni (68.3%), papunësia (65%) dhe varfëria (30%) kanë qenë tri problemet më të rëndësishme. Nxënësit nga Komuna e Mitrovicës kanë zgjedhur korrupsionin (63.2%), papunësinë (61.4%) dhe varfërinë (38.6%). Ndërsa sa i përket Komunës së Prishtinës, nxënësit kanë zgjedhur korrupsionin (71.3%), papunësinë (61.3%) dhe varfërinë (46%) si problemet më të rëndësishme me të cilat ballafaqohet Kosova.

FIGURA 11
NXËNËSIT - TRE PROBLEMET KRYESORE NË KOSOVË

	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna
	Prishtinë	Mitrovicë	Gjakove	Podujeve	Ferizaj
Puna e Qeverisë së Kosovës	46.0%	31.6%	25.0%	30.2%	28.8%
Puna e Kuvendit të Kosovës	9.3%	24.6%	13.3%	17.0%	16.3%
Reformat e administratës publike	1.3%	3.5%		3.8%	
Korrupsioni	71.3%	63.2%	68.3%	60.4%	56.3%
Niveli u ulët i zhvillimit ekonomik	24.0%	24.6%	18.3%	20.8%	13.8%
Varfëria / Niveli i ulët i standardit të jetës	35.3%	38.6%	30.0%	52.8%	32.5%
Papunësia	61.3%	61.4%	65.0%	54.7%	75.0%
Funksionimi i dobët i sistemit të drejtësisë	7.3%	10.5%	13.3%	9.4%	12.5%
Funksionimi i dobët i sistemit shëndetësor	2.7%	7.0%	8.3%	13.2%	11.3%
Funksionimi i dobët i sistemit arsimor	4.7%	5.3%	10.0%	9.4%	10.0%
Prishja e mjedisit / rrethit jetësor	2.7%	8.8%	11.7%	1.9%	6.3%
Kriminaliteti dhe pasiguria	6.0%	10.5%	8.3%	11.3%	15.0%
Procesi i njohjeve të Kosovës	1.3%	1.8%	3.3%		2.5%
Procesi i Liberalizimit të Vizave	11.3%	5.3%	11.7%	11.3%	10.0%
Në përgjithësi procesi i integrimi evropiane	0.7%		3.3%	1.9%	5.0%


Megjithatë studentët përfaqësojnë një strukturë shumë heterogjene për sa i përket vendit nga vijnë, analizimi i të dhënave të nxjerra nga përgjigjet e kësaj kategorie të mostrës së hulumtimit, është bërë përmes analizës së përgjithshme, duke shmangur krostabulimin për komuna, i cili është aplikuar në rastin e nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Sa i përket pyetjes se cilat janë tri problemet më të rëndësishme me të cilat ballafaqohet Kosova, bazuar në rezultatet e nxjerra gjatë intervistimit të studentëve ka dalur të jetë korrupsioni (73%), papunësia (54.7%) dhe varfëria (27.3%).

73 %

e studentëve mesatarisht janë përgjigjur se korrupsioni është problem kryesor në Kosovë

FIGURA 12
STUDENTËT - TRE PROBLEMET KRYESORE NË KOSOVË



Pjesë e pyetësorit për të matur opinionin dhe perceptimin e respondentëve, ishin edhe deklaratat e paraqitura në të përmes të cilave nga respondentët është kërkuar të deklarojnë nëse pajtohen apo jo me të njëjtat (grafikonet e mëposhtme).

Duke i analizuar përgjigjet e dhëna nga mësimitdhënësit, del që në të gjitha komunat përveç në Komunën e Prishtinës, mësimitdhënësit mendojnë se personat që janë të gatshëm të gënjejnë, mashtrojnë, nuk respektojnë ligjet dhe të korruptuarit kanë më shumë gjasa të arrijnë në jetë se sa ata që nuk janë të tillë.

FIGURA 13
MËSIMDHËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DY DEKLARATA?






FIGURA 14
NXËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DY DEKLARATA?



Nxënësit në anën tjetër kanë qenë më optimist sa i përket pajtimit me këto deklaratë. Nxënësit e intervistuar në të gjitha komunat janë pajtuar në përqindje më shumë me deklaratën se personat që janë të ndershëm, me nivel të lartë të integritetit kanë më shumë gjasa të arrijnë në jetë se sa ata që nuk janë të tillë, sesa me deklaratën ku personat që janë të gatshëm të gënjejnë, mashtrojnë, nuk respektojnë ligjet dhe të korruptuarit, kanë më shumë gjasa të arrijnë në jetë se sa ata që nuk janë të tillë.

Ngjashëm me nxënësit edhe studentët mendojnë se personat që janë të ndershëm, me nivel të lartë të integritetit kanë më shumë gjasa të arrijnë në jetë se sa ata që nuk janë të tillë.

FIGURA 15
STUDENTËT - A PAJTOHENI ME KËTO DY DEKLARATA?



- Personat që janë të gatshëm të gënjejnë, mashtrojnë, nuk respektojnë ligjet dhe të korruptuarit kanë më shumë gjasa të arrijnë në jetë se sa ata që nuk janë të tillë
- Personat që janë të ndershëm, me nivel të lartë të integritetit kanë më shumë gjasa të arrijnë në jetë se sa ata që nuk janë të tillë.

Respondentët poashtu janë pyetur lidhur me nivelin e korrupsionit në institucionet e ndryshme në Kosovë. Institucionet më të korruptuara sipas mësimdhënësve janë: Qeveria e Kosovës, Prokuroria e Kosovës, Gjykatat e Kosovës pastaj Kuvendi i Kosovës, Partitë Politike, Universitetet Private dhe Publike gjersa Administrata Shtetërore, Policia, Shkollat, Mediat dhe Organizatat Joqeveritare janë vlerësuar si institucione më pak të korruptuara nga mësimdhënësit.

Ngjashëm si mësimdhënësit edhe nxënësit janë të pajtimit se Qeveria, Kuvendi i Kosovës, Partitë Politike, Gjykatat, Universitetet Private dhe Publike, Prokuroria, Shkollat, Komunat janë institucionet më të korruptuara gjersa për Policinë, Administratën Shtetërore, Mediat dhe Organizatat Joqeveritare, nxënësit kanë mendim që janë më pak të korruptuara.

Për dallim prej dy kategorive të mësipërme të respondentëve, studentët e intervistuar janë të mendimit se të gjitha institucionet e lartëpërmendura janë të korruptuara ku më të veçuara janë Qeveria, Gjykatat, Prokuroria, Partitë Politike dhe Universitetet Private.

4.2. PROBLEMET NË SISTEMIN E EDUKIMIT

Për të vlerësuar qëndrimet e kategorive të këtij hulumtimi për cilësinë, gjendjen aktuale dhe në tërësi nivelin e arsimit në Kosovë, domosdoshmërisht është dashur të kërkohet një opinion vlerësues mbi kënaqshmërinë që këto kategori kanë për sistemin e edukimit.

Të pyetur se sa janë të kënaqur me sistemin e edukimit në Kosovë, shumica e mësimdhënësve janë deklaruar deri diku të kënaqur me përjashtim të Komunës së Podujevës, ku rreth 60% të mësimdhënësve janë deklaruar ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur.

FIGURA 16
MËSIMDHËNËSIT - SA JENI TË KËNAQUR ME SISTEMIN ARSIMOR?




FIGURA 17
NXËNËSIT - SA JENI TË KËNAQUR ME SISTEMIN ARSIMOR?






FIGURA 18
STUDENTËT - SA JENI TË KËNAQUR ME SISTEMIN ARSIMOR?




Në pyetjen se cila është gjendja aktuale e etikës dhe përgjegjshmërisë në Sistemin e Edukimit në Kosovë, mësime dhënësit nga Mitrovica kanë qenë më pozitiv në vlerësim me 3.19 (në shkallë vlerësimi prej 1 deri 5 ku 1=Aspak e pranueshme dhe 5=Plotësisht e pranueshme), gjersa mësime dhënësit e Prishtinës e kanë vlerësuar më ulët me 2.51 (në shkallë vlerësimi prej 1 deri 5 ku 1=Aspak e pranueshme dhe 5=Plotësisht e pranueshme).

FIGURA 19
MËSIMDHËNËSIT - SIPAS MENDIMIT TUAJ, CILA ËSHTË GJENDJA AKTUALE E ETIKËS DHE PËRGJEG-JSHMËRISË NË SISTEMIN E EDUKIMIT NË KOSOVË?



Në të njëjtën pyetje, nxënësit nga Podujeva kanë qenë më pozitiv në vlerësim me 3.47 (në shkallë vlerësimi prej 1 deri 5 ku 1=Aspak e pranueshme dhe 5=Plotësisht e pranueshme), gjersa nxënësit e Prishtinës e kanë vlerësuar më ulët me 2.87 (në shkallë vlerësimi prej 1 deri 5 ku 1=Aspak e pranueshme dhe 5=Plotësisht e pranueshme) gjendjen aktuale të etikës dhe

FIGURA 20
NXËNËSIT - SIPAS MENDIMIT TUAJ, CILA ËSHTË GJENDJA AKTUALE E ETIKËS DHE PËRGJEG-JSHMËRISË NË SISTEMIN E EDUKIMIT NË KOSOVË?



Gjersa për studentët për shkak se janë intervistuar nga të gjitha komunat, është nxjerrë një vlerësim i përgjithshëm, ku në shkallë vlerësimi prej 1 deri 5 ku 1=Aspak e pranueshme dhe 5=Plotësisht e pranueshme, gjendjen aktuale të etikës dhe përgjegjshmërisë në Sistemin e Edukimit në Kosovë, e kanë vlerësuar me 2.83

FIGURA 21

STUDENTËT - SIPAS MENDIMIT TUAJ, CILA ËSHTË GJENDJA AKTUALE E ETIKËS DHE PËRGJEGJSHMËRISË NË SISTEMIN E EDUKIMIT NË KOSOVË?



Mësidhënësit janë pyetur se a pajtohen me disa deklaratat duke i ranguar në shkallë vlerësimi prej 1 deri 5 ku 1=Aspak nuk pajtohem dhe 5=Plotësisht pajtohem, e që kanë të bëjnë me sjelljet e nxënësve në shkollë pastaj me sjelljet e mësimitdhënësve dhe të prindërve në shkollë. Mësimdhënësit e komunave të ndryshme, në përgjigjet e dhëna nuk kanë dalluar njëri prej tjetrit veçse të gjithë së bashku për disa deklaratat janë pajtuar dhe për disa tjera jo.

Fillimisht shumica e mësimitdhënësve janë pajtuar me deklaratat ku trajtohen sjelljet e nxënësve në shkollë gjegjësisht kur nxënësit kopjojnë detyrat e shtëpisë nga shokët/shoqet e tyre apo kur nxënësit kopjojnë përgjigjet e testeve nga shokët/shoqet, gjatë realizimit të testimit (më e larta në Ferizaj=3.45). Gjersa sa i përket deklaratave ku trajtohen sjelljet e mësimitdhënësve dhe prindërve, mësimitdhënësit në shumicë, nuk janë pajtuar se në shkollat e tyre: a. prindërit e nxënësve paguajnë ose realizojnë ndonjë shërbim stafit menaxherial të shkollës, me qëllim që t'ua ndryshojnë notat fëmijëve të tyre; b.

Nxënësit paguajnë ose realizojnë ndonjë shërbim/punë për stafin menaxherial të shkollës, me qëllim që t'ua ndryshojnë notat atyre (më e ulëta Ferizaj=1.62); c. mësimitdhënësit e shkollës ofrojnë kurse jashtë shkollës, që duhet të paguhet për to; apo d. nxënësit në shkollë që dështojnë në teste "mund" ta kalojnë atë nëse ata paguajnë ose realizojnë ndonjë shërbim/punë ndaj mësimitdhënësve.

FIGURA 22

MËSIMDHËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM

	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna
	Prishtinë	Mitrovicë	Gjakove	Podujeve	Ferizaj
Nxënësit kopjojnë detyrat e shtëpisë nga shokët/shoqet e tyre.	3.39	3.38	3.43	3.20	3.19
Nxënësit kopjojnë përgjigjet e testeve nga shokët/shoqet gjatë realizimit të testimit.	3.12	3.06	3.00	3.30	3.45
Prindërit e nxënësve paguajnë ose realizojnë ndonjë shërbim stafit menaxherial të shkollës me qëllim që t'ua ndryshojnë notat fëmijëve të tyre.	1.82	2.38	1.79	1.80	2.05
Nxënësit paguajnë ose realizojnë ndonjë shërbim/punë për stafin menaxherial të shkollës me qëllim që t'ua ndryshojnë notat atyre.	1.76	2.25	2.13	1.80	1.62
Mësimdhënësit e shkollës suaj ofrojnë kurse jashtë shkollore që duhet të paguhen për to.	2.00	3.06	2.86	2.90	2.57
Nxënësit në shkollën tuaj që dështojnë në teste "mund" ta kalojnë atë nëse ata paguajnë ose realizojnë ndonjë shërbim/punë ndaj mësimdhënësve.	1.81	2.56	1.93	1.80	1.71

Në anën tjetër edhe nxënësit e intervistuar, duke përdorur shkallën e vlerësimit prej 1 deri 5 ku 1=Aspak nuk pajtohem dhe 5=Plotësisht pajtohem pothuajse kishin mendim të ngjashëm me mësimdhënësit lidhur me atë se a kopjojnë nxënësit apo jo nga shokët e tyre dhe në anën tjetër ishin kategorik se nxënësit kryejnë shërbime apo paguajnë mësimdhënësit e tyre. Për dallim prej mësimdhënësve, nxënësit e intervistuar në shumicë janë pajtuar se mësimdhënësit e shkollës ofrojnë kurse jashtë shkollore që duhet të paguhen për to. Më pak të ranguara nga ana e nxënësve kanë qenë deklaratat që kanë pasur të bëjnë me ofrimin e pagesave apo shërbimeve, nga ana e nxënësve tek stafi i institucioneve arsimore.

FIGURA 23


NXËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM.

	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna
	Prishtinë	Mitrovicë	Gjakove	Podujeve	Ferizaj
Nxënësit kopjojnë detyrat e shtëpisë nga shokët/shoqet e tyre.	3.80	3.74	3.90	3.75	3.82
Nxënësit kopjojnë përgjigjet e testeve nga shokët/shoqet gjatë realizimit të testimit.	3.34	3.28	3.59	3.25	3.29
Prindërit e nxënësve paguajnë ose realizojnë ndonjë shërbim stafit menaxherial të shkollës me qëllim që t'ua ndryshojnë notat fëmijëve të tyre.	2.59	2.32	2.80	2.42	2.25
Nxënësit paguajnë ose realizojnë ndonjë shërbim/punë për stafin menaxherial të shkollës me qëllim që t'ua ndryshojnë notat atyre.	2.54	2.24	2.47	2.30	2.16
Mësimdhënësit e shkollës suaj ofrojnë kurse jashtë shkollore që duhet të paguhen për to.	3.29	3.08	3.54	3.17	3.19
Nxënësit në shkollën tuaj që dështojnë në teste "mund" ta kalojnë atë nëse ata paguajnë ose realizojnë ndonjë shërbim/punë ndaj mësimdhënësve.	2.55	2.31	2.17	2.28	2.11

Edhe studentët kryesisht kanë ranguar më së miri deklaratat ku thonë se studentët kopjojnë përgjigjet e testeve apo kopjojnë detyrat shkollore (seminaret) dhe më së ulëti deklaratat ku theksohet dhënia e ndonjë pagese, për të kryer shërbime në institucion arsimor.

FIGURA 24

STUDENTËT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM.



4.3. KORRUPSIONI NË SISTEMIN E EDUKIMIT

Temë tjetër e shtjelluar përmes këtij hulumtimi, ka qenë edhe korrupsioni në sistemin e edukimit në Kosovë përmes pyetjeve ku janë pyetur respondentët (mësimdhënësit, nxënësit, dhe studentët) rreth aktiviteteve korruptive në shkolla dhe sjelljet e zyrtarëve të ndryshëm në shkollë. Fillimisht respondentëve u janë prezantuar disa deklaratë lidhur me sjelljet e stafit menaxherial të shkollave dhe u është kërkuar të deklarohen se a pajtohen apo jo. Mësimdhënësit në shumicë siç edhe mund t'i shihni nga grafikonet e mëposhtme nuk pajtohen me këto deklaratë përveç deklaratës së tretë, ku mësimdhënësit e Mitrovicës e kanë ranguar më lartë (2.63) deklaratën se stafi menaxherial i shkollës u jep përparësi anëtarëve të familjeve, të afërmeve dhe miqve të tyre, në rastin e pranimit të nxënësve në shkollë.

FIGURA 25
MËSIMDHËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM.

	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna
	Prishtinë	Mitrovicë	Gjakove	Podujeve	Ferizaj
Është e zakonshme që nxënësit e shkollës si me t'u japin rryshfet stafit menaxherial të shkollës me qëllim që t'i kryejnë punët në mënyrë efikase.	1.69	1.94	2.20	1.70	1.55
Stafi menaxherial i shkollës shfrytëzon të mirat materiale të shkollës për përfitime personale.	1.73	1.94	1.79	2.00	2.09
Stafi menaxherial i shkollës u jep përparësi anëtarëve të familjeve, të afërmeve dhe miqve të tyre në rastin e pranimit të nxënësve në shkollë.	1.90	2.63	2.21	2.20	2.43

Nxënësit nga të gjitha komunat, e kanë ranguar më së larti deklaratën se stafi menaxherial i shkollës u jep përparësi anëtarëve të familjeve, të afërmeve dhe miqve të tyre, në rastin e pranimit të nxënësve në shkollë.

FIGURA 26


NXËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM

	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna
	Prishtinë	Mitrovicë	Gjakove	Podujeve	Ferizaj
Është e zakonshme që nxënësit e shkollës sime t'u japin rryshfet stafit menaxherial të shkollës me qëllim që t'i kryejnë punët në mënyrë efikase.	2.27	2.23	2.43	2.40	2.29
Stafi menaxherial i shkollës shfrytëzon të mirat materiale të shkollës për përfitime personale.	2.38	2.18	2.29	2.30	2.28
Stafi menaxherial i shkollës u jep përparësi anëtarëve të familjeve, të afërmeve dhe miqve të tyre në rastin e pranimit të nxënësve në shkollë.	3.35	3.25	3.29	2.98	3.19

Në anën tjetër studentët e intervistuar kanë menduar pak më ndryshe se respondentët e lartpërmendur. Ata kanë ranguar më së paku (2.39) deklaratën që ka pasur të bëjë me dhenien e rryshfetit nga studentët tek stafi menaxherial për të kryer ndonjë shërbim efikas. Gjersa për dy deklaratat tjera, ata janë pajtuar se: a. Stafi menaxherial i fakultetit shfrytëzon të mirat materiale të shkollës për përfitime personale (3.25); dhe b. Stafi menaxherial i fakultetit u jep përparësi anëtarëve të familjeve, të afërmeve dhe miqve të tyre, në rastin e pranimit të nxënësve në shkollë (2.76), duke nxjerrë kështu në pah ekzistimin e nepotizmit dhe konfliktit të interesit personal me atë publik.


FIGURA 27

STUDENTËT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM.




Më pas respondentët janë pyetur se a pajtohen me dy deklaratat tjera, që kanë të bëjnë me dhënien e parave tek mësimdhënësit në shkëmbim të arritjes së notave më të mira dhe a ka mekanizma brenda shkollës, që i luftojnë këto dukuri. Sa i përket deklaratës së parë, mësimdhënësit nuk janë pajtuar se në shkollat e tyre ekziston praktika e dhënies së dhuratave/parave në shkëmbim të notave më të mira përveç në Mitrovicë (3.4). Gjersa për deklaratën e dytë, mësimdhënësit janë pajtuar duke thënë se shkollat ku ata punojnë, kanë mekanizma përmes së cilave luftohen këto dukuri.

FIGURA 28
MËSIMDHËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA?




Edhe nxënësit e intervistuar janë përgjigjur njëjtë duke mos u pajtuar me deklaratën se në shkollat e tyre, u jepen para mësimdhënësve në shkëmbim të arritjes së notave më të mira. Gjersa në anën tjetër ata mendojnë se ekzistojnë mekanizma brenda shkollës, që i luftojnë këto dukuri.

FIGURA 29
NXËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM.



Për sa i përket çështjes së mekanizmave ndëshkues apo dhënies së dhuratave/parave profesorëve, studentët mesatarisht janë pajtuar më deklaratat e paraqitura në grafikonin e mëposhtëm.

FIGURA 30
STUDENTËT – A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM.



Të gjitha kategorive të respondentëve, i'u është shtruar pyetja direkte se sa është i përhapur aktualisht korrupsioni në Arsimin e Mesëm të Lartë. Shumica e mësimitdhënësve mendojnë se korrupsioni është i përhapur por jo në nivele të larta sikurse në institucione tjera.

FIGURA 31
MËSIMDHËNËSIT - SA ËSHTË I PËRHAPUR KORRUPSIONI NË KOSOVË?

	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna
	Prishtinë	Mitrovicë	Gjakove	Podujeve	Ferizaj
Shumë i përhapur			6.7%		4.5%
I përhapur	24.3%	12.5%	13.3%	40%	18.2%
I përhapur deri diku	24.3%	25.0%	33.3%	30%	31.8%
Nuk është shumë i përhapur	16.2%	50%	20%	20%	18.2%
Nuk është aspak i përhapur	10.8%		13.3%	10%	4.5%
Nuk e di	21.6%	12.5%	13.3%		22.7%
Refuzon të përgjigjet	2.7%				

Lidhur me korrupsionin në Arsimin e Mesëm të Lartë, mësimitdhënësve i'u është kërkuar të deklarohen se a pajtohen apo jo me disa deklaratat që kanë të bëjnë me ndikimin potencial të korrupsionit në Arsimin e Mesëm të Lartë. Shumica e mësimitdhënësve të komunave që janë intervistuar, janë pajtuar (i kanë ranguar lartë) deklaratat se korrupsioni ndikon në kualitetin e edukimit, në planet e njerëzve për të studiuar dhe punuar në shkollat e mesme publike, ndikon në entuziazmin e mësimitdhënësve për angazhim shtesë, ndikon në kapacitetet e nxënësve për të mësuar, dëmton imazhin e përgjithshëm të mësimitdhënësit dhe ndikon direkt në zhvillimin e edukimit në përgjithësi.

Sa i përket pyetjes se a është rritur viteve të fundit korrupsioni në sistemin e edukimit, mendimet e mësimitdhënësve janë të përziera përderisa disa mendojnë se është rritur, disa mendojnë se gjendja është e njëjtë, disa të tjerë mendojnë se është zvogëluar e disa nuk kanë informacion dhe nuk kanë dashur të përgjigjen.

FIGURA 32

MËSIMDHËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM


	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna	Komuna
	Prishtinë	Mitrovicë	Gjakove	Podujeve	Ferizaj
Korrupsioni në Arsimin e Mesëm të Lartë ndikon direkt në kualitetin e edukimit të mesëm	3.77	3.81	4.47	4.30	4.19
Korrupsioni në Arsimin e Mesëm të Lartë ndikon direkt në dëshirën dhe planet e njerëzve për të studiuar dhe punuar në shkollat e mesme publike	3.70	3.44	3.86	3.80	3.81
Korrupsioni në Arsimin e Mesëm të Lartë ndikon direkt në entuziazmin për mësimdhënie dhe angazhime shtesë të mësimdhënësve në Arsimin e Mesëm të Lartë	3.32	3.44	3.86	3.90	3.89
Korrupsioni në Arsimin e Mesëm të Lartë ndikon direkt në kapacitetet e nxënësve për të studiuar dhe angazhuar në punët dhe detyrat e shkollës	3.58	3.50	4.14	3.80	3.50
Korrupsioni në Arsimin e Mesëm të Lartë dëmton imazhin e mësimdhënësve dhe ndikon në uljen e statusit të tyre social	4.09	4.50	4.07	4.40	4.74
Korrupsioni në Arsimin e Mesëm të Lartë ndikon direkt në zhvillimin e edukimit në përgjithësi në Kosovë	4.10	4.44	4.36	4.50	4.26

FIGURA 33
MËSIMDHËNËSIT - A ËSHTË RRITUR KORRUPSIONI NË KOSOVË?

	Komuna Prishtinë	Komuna Mitrovicë	Komuna Gjakove	Komuna Podujeve	Komuna Ferizaj
Është rritur	32.4%	68.8%	26.7%	30%	18.2%
Ka mbetur i njëjtë	16.2%	12.5%	13.3%	30%	27.3%
Është zvogëluar	24.3%	12.5%	26.7%	30%	9.1%
Nuk e di/PP	27%	6.3%	33.3%	10%	45.5%

Për të parë se si ata e shohin trendin e dukurisë së korrupsionit në sistemin e edukimit në Kosovë, mësimdhënësit janë pyetur se a do të rritet niveli i korrupsionit në sistemin e edukimit në Kosovë dhe numri më i madh i mësimdhënësve mendojnë se do të zvogëlohet në krahasim me ata që mendojnë se do të rritet apo do të mbetet i njëjtë.


FIGURA 34
MËSIMDHËNËSIT - A DO TË RRITET NIVELI I KORRUPSIONIT NË SISTEMIN E EDUKIMIT NË KOSOVË?



Mësimdhënësit pastaj janë pyetur më hollësisht rreth nivelit të korrupsionit në sektorë të ndryshëm të Arsimit të Mesëm të Lartë dhe si e vlerësojnë atë. Sa i përket projekteve të ndërtimeve dhe furnizimit me blerje për shkolla, mësimdhënësit mendojnë se niveli i korrupsionit është i lartë.

Sa i përket pranimit të nxënësve në shkollë mësimdhënësit kanë dhënë përgjigje të ndryshme, ku disa mendojnë se është i lartë dhe deri diku i lartë korrupsioni, gjersa pjesa tjetër mendojnë të kundërtën pra që është i ulët apo shumë i ulët.

FIGURA 35
MËSIMDHËNËSIT - NIVELI I KORRUPSIONIT I PROJEKTEVE TË NDËRTIMEVE DHE FURNIZIMIT ME BLERJE PËR SHKOLLA



Njëjte mendojnë mësimdhënësit edhe lidhur me çështjen e vlerësimeve edukative, ku një pjesë e mësimdhënësve mendojnë se niveli i korrupsionit është deri diku i lartë (mësimdhënësit nga Komunat e Podujevës dhe Mitrovicës), e një pjesë e madhe e tyre mendojnë se është i ulët apo shumë i ulët.

FIGURA 36
MËSIMDHËNËSIT - NIVELI I KORRUPSIONIT - VLERËSIMET EDUKATIVE




FIGURA 37
MËSIMDHËNËSIT - PRANIMI I NXËNËSVE NË SHKOLLË





FIGURA 38


MËSIMDHËNËSIT – NIVELI I KORRUPSIONIT - RITJJA E NUMRIT TË MËSIMDHËNËSVE, DHE PROMOVIMI I KUADROVE NË SHKOLLË



Sa i përket çështjes së rritjes së numrit të mësimitdhënësve dhe promovimi i kuadrove në shkollë, numri më i madh i mësimitdhënësve mendojnë se niveli i korupsionit është i lartë në krahasim me ata që mendojnë se është i ulët apo shumë i ulët.

FIGURA 39


MËSIMDHËNËSIT – NIVELI I KORRUPSIONIT - NOTIMI I NXËNËSVE, DHE ZGJEDHJA E NXËNËSVE MË TË MIRË



Procesi i notimit të nxënësve dhe zgjedhjes së nxënësve më të mirë është një çështje tjetër të cilës i është kushtuar rëndësi e veçantë, për të nxjerrë në pah nëse nxënësit vlerësohen mbi kriteret e dijes që kanë apo nëse edhe në këtë proces vlerësues ka tendenca të pabarazisë dhe favorizimit të nxënësve individualisht. Për këtë mësimitdhënësit mendojnë se niveli i korupsionit është i ulët apo shumë i ulët përveç mësimitdhënësve në Komunën e Mitrovicës, që e vlerësojnë lartë apo deri diku lartë nivelin e korupsionit për këtë çështje.

Duke pasur parasysh se nivelit komunal i janë bartur kompetenca si bartës i detyrimeve për procesin arsimor në Kosovë dhe se rezultatet si dhe procesi i arsimit në secilën komunë menaxhohet nga Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe në tërësi nga struktura qeverisëse të nivelit të komunave, përmes hulumtimit është tentuar të nxirret perceptimi mbi korrupsionin tek po këta funksionarë publik.


FIGURA 40
MËSIMDHËNËSIT - CILËT UDHËHEQËS KOMUNALË JANË MË TË KORRUPTUAR?



Ky hulumtim ka pasur për qëllim që të nxjerrë perceptimin real të respondentëve që kanë të bëjnë me të gjitha strukturat hierarkike në menaxhimin e sistemit arsimor komunal dhe atij universitar, duke tentuar kështu të kuptohet saktë gjendja aktuale a parë nga vetë akterët dhe përfituesit e arsimit edukativ-nxënës dhe studentë.


Të pyetur se sa janë të korruptuar udhëheqësit e shkollës, shumë prej tyre mendojnë se asnjë udhëheqës i shkollës nuk është i korruptuar gjersa të tjerët i kanë identifikuar si përgjegjës për infrastrukturë, blerje dhe furnizime si më të korruptuarit në ambientet shkollore si dhe ata që menaxhojnë me buxhet dhe financa, duke aluduar kështu në ekzistimin e korrupsionit si dukuri në vetë shkollat ku ata/ato punojnë.

FIGURA 41
MËSIMDHËNËSIT - CILËT UDHËHEQËS TË SHKOLLËS JANË TË KORRUPTUAR?




Në fund, lidhur me korrupsionin në shkollë, mësimdhënësve u është kërkuar mendimi se a pajtohen apo jo lidhur me disa deklaratat, që kanë të bëjnë me shkaqet e korrupsionit në Arsimin e Mesëm e të Lartë. Mësimdhënësit më së larti i kanë vlerësuar deklaratat në vijim: a. Vendimmarrja në shkolla është jo transparente dhe jo llogaridhënëse, b. Mekanizmat vlerësues nuk janë mirë të dizajnuar dhe të zbatuar dhe kjo lë hapësirë për korrupsion, c. Mungesa e auditimit të jashtëm dhe mbikëqyrja financiare, d. Promovimi i personelit në Arsimin e Mesëm të Lartë krijon tendencën e korrupsionit në shkolla, e. Udhëheqësit e shkollës (Drejtori, Zëvendës Drejtori, Sekretari i Shkollës) janë politikisht shumë të fuqishëm në mënyrë që ata të mbikëqyren dhe f. Të ardhurat personale të mësimdhënësve në Arsimin e Mesëm të Lartë, janë shumë të ulëta dhe në shpërputhje me performancën që u kërkohej atyre. Deklaratat për të cilat mësimdhënësit nuk janë pajtuar kanë qenë 1. Buxheti i pamjaftueshëm shtynë shkollat që të shfrytëzojnë mënyra dhe metoda ilegale, për të mbijetuar dhe “zhvilluar” dhe 2. Regjistrimi i nxënësve nuk është transparent, gjë e cila shtynë marrjen e veprimeve të fshehta nga publiku.

FIGURA 42
MËSIMDHËNËSIT - A PAJTOHENI MË KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM




Po ashtu edhe nxënësit dhe studentët e intervistuar janë pyetur lidhur me korrupsionin në sistemin arsimor, ku disa pyetje kanë pasur të bëjnë me përvojat e tyre personale. Nxënësit janë pyetur se a kanë shfrytëzuar lidhjet personale për të arritur avantazhe në shkollë siç mund të jetë marrja e një note pozitive, në ndonjë lëndë që nuk e kanë merituar dhe një numër shumë i vogël i tyre janë përgjigjur pozitivisht.

FIGURA 43
NXËNËSIT - A KENI SHFRYTËZUAR LIDHJET PERSONALE PËR TË ARRITUR AVANTAZHDE NË SHKOLLË?




Në të njëjtën pyetje vetëm 4% e studentëve kanë pranuar se kanë shfrytëzuar lidhjet personale për të arritur avantazhe në fakultet siç mund të jetë marrja e një note pozitive, në ndonjë lëndë që nuk e kanë merituar.

FIGURA 44
STUDENTËT - A KENI SHFRYTËZUAR LIDHJET PERSONALE PËR TË ARRITUR AVANTAZHDE NË SHKOLLË?



Të pyetur se a janë normale sjelljet e tilla, shumica e nxënësve mendojnë se nuk janë normale.


FIGURA 45
NXËNËSIT - A JANË NORMALE SJELLJE TË TILLA KORRUPTIVE?



Duhet të theksohet se vërehet një numër më i madh i nxënësve që i pranojnë këto veprime, që nënkupton se edhe nxënës që nuk kanë ndërmarrë veprime të tilla, i pranojnë ato veprime si normale.

Tek studentët, në numër më të vogël i pranojnë veprime korruptive të lartpërmendura si normale (9.3%).

FIGURA 46
STUDENTËT - A JANË NORMALE SJELLJE TË TILLA KORRUPTIVE?



Në vazhdim nxënësit/studentët janë pyetur se a ju ka ndodhur të paguanin ryshfet për të përmirësuar nota, për t'iu pranuar në shkollë/fakultet apo për t'iu shmangur/zbutur masat disiplinore. Në të gjitha rastet numër shumë i vogël i nxënësve/studentëve, kanë pranuar të kenë paguar apo ofruar ryshfet, për të realizuar ndonjë prej qëllimeve të lartpërmendura.

FIGURA 47
NXËNËSIT – A KENI PAGUAR RYSHFET PËR TË PËRMIRËSUAR NOTAT?




FIGURA 48
STUDENTËT – A KENI PAGUAR RYSHFET PËR TË PËRMIRËSUAR NOTAT?




FIGURA 49
NXËNËSIT - A KENI PAGUAR PËR T'U PRANUAR NË SHKOLLË?




FIGURA 50
STUDENTËT - A KENI PAGUAR PËR T'U PRANUAR NË SHKOLLË?




FIGURA 51
 NXËNËSIT – A KENI PAGUAR PËR T’IU SHMANGUR/ZBUTUR MASAT DISCIPLINORE






FIGURA 52
 STUDENTËT – A KENI PAGUAR PËR T’IU SHMANGUR/ZBUTUR MASAT DISCIPLINORE




Lidhur me këto veprime korruptive janë pyetur nxënësit dhe studentët, se a janë normale për ta. Përsëri numri i atyre që i marrin këto veprime korruptive si normale, është më i lartë se i atyre që kanë pranuar se kanë kryer veprime të tilla, që do të thotë se edhe pse nuk kanë kryer veprime të tilla korruptive, ka nxënës që i konsiderojnë si diçka normale.

FIGURA 53
NXËNËSIT - A JANË NORMALE SJELLJET E TILLA KORRUPTIVE?



Përsëri, është më i vogël numëri i studentëve (5%) në krahasim me nxënësit që i kanë pranuar këto veprime korruptive si normale.

FIGURA 54
STUDENTET - A JANË NORMALE SJELLJET E TILLA KORRUPTIVE?



Numër më i madh i nxënësve dhe studentëve në përqindje, mendojnë se viteve të fundit niveli i korrupsionit në sistemin e edukimit është rritur apo ka mbetur i njëjtte gjersa numri i atyre që mendojnë se niveli i korrupsionit në sistemin e edukimit në Kosovë është zvogëluar është më i ulët.

FIGURA 55
NXËNËSIT - A ËSHTË RRIUR NIVELI I KORRUPSIONIT NË SISTEMIN E EDUKIMIT?





FIGURA 56
STUDENTËT - A ËSHTË RRIUR NIVELI I KORRUPSIONIT NË SISTEMIN E EDUKIMIT?




4.4. MEKANIZMAT PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT

Përmes këtij hulumtimi është tentuar të merren informata dhe të vlerësohet se sa dinë mësime dhënësit, studentët dhe nxënësit, lidhur me mekanizmat për luftimin e korrupsionit. Shumica e pyetjeve kanë të bëjnë me mënyrat e luftimit, mekanizmat, palët e involvuara dhe autoritetet përgjegjëse, që merren me luftimin e korrupsionit.


Fillimisht u janë lexuar deklaratat që kanë të bëjnë me shkollën/fakultetin, ku punojnë/vijojnë mësime dhënësit, nxënësit dhe studentët. Në këtë pyetje mësime dhënësit sipas rezultateve të dalta nga terreni, del që i kanë ranguar deklaratat lartë. Në Prishtinë mësime dhënësit i kanë ranguar më së larti deklaratat ndërkaq mësime dhënësit nga Mitrovica i kanë ranguar më së ulëti.

FIGURA 57
MËSIMDHËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM



Mësimdhënësit janë pyetur se sa janë efektive mekanizmat që i aplikon shkolla për promovimin e etikës, përgjegjshmërisë dhe luftës kundër korrupsionit. Pjesa më e madhe e mësimdhënësve, kanë dhënë vlerësim pozitiv dhe i vlerësojnë këto mekanizma si deri diku efektive dhe plotësisht efektive. Një numër shumë i vogël i ka vlerësuar këto mekanizma, si joefektive apo aspak efektive.

FIGURA 58
MËSIMDHËNËSIT - SA EFEKTIVE JANË MEKANIZMAT QË I APLIKON SHKOLLA PËR PROMOVIMIN E ETIKËS, PËRGJEGJSHMËRISË DHE LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT?



Në anën tjetër edhe nxënësit e studentët pajtohen lidhur me masat që i promovon shkolla kundër korrupsionit përmes mënyrave të ndryshme, duke i ranguar lartë deklaratat e paraqitura në grafikonet e mëposhtme.

FIGURA 59

NXËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM





FIGURA 60

STUDENTËT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? VLERËSO PREJ 1 DERI 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DHE 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM



Poashtu edhe nxënësit/studentët kanë dhënë mendimin e tyre lidhur me atë se sa efektive janë mekanizmat që i aplikon shkolla për promovimin e etikës, përgjegjshmërisë dhe luftës kundër korrupsionit. Ngjashëm sikurse mësimmshënësit edhe nxënësit/studentët, i kanë vlerësuar këto mekanizma si efektive apo deri diku efektive.

FIGURA 61

NXËNËSIT - SA EFEKTIVE JANË MEKANIZMAT QË I APLIKON SHKOLLA PËR PROMOVIMIN E ETIKËS, PËRGJEGJSHMËRISË DHE LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT?






FIGURA 62

STUDENTET- SA EFEKTIVE JANË MEKANIZMAT QË I APLIKON SHKOLLA PËR PROMOVIMIN E ETIKËS, PËRGJEGJSHMËRISË DHE LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT?



Në vijim, respondentëve (mësimdhënësit, nxënësit dhe studentët) u është kërkuar të japin mendim lidhur me atë se gjatë viteve të fundit autoritet publike vendore a kanë zbatuar politika apo masa efektive kundër korrupsionit në sistemin e edukimit. Mësimdhënësit kryesisht mendojnë se nuk ka pasur përpjekje të vërtetë për të zbatuar masa kundër korrupsionit apo edhe nëse ato masa janë zbatuar, efektet kanë qenë të vogla.

FIGURA 63
MËSIMDHËNËSIT - GJATË VITEVE TË FUNDIT AUTORITET PUBLIKE VENDORE A KANË ZBATUAR POLITIKA APO MASA EFEKTIVE KUNDËR KORRUPSIONIT NË SISTEMIN E EDUKIMIT?



Edhe nxënësit dhe studentët kur janë pyetur lidhur me këtë çështje, kanë qenë të mendimit se nuk ka pasur përpjekje të vërteta për të zbatuar masa kundër korrupsionit apo edhe nëse ato masa janë zbatuar, efektet kanë qenë të vogla.

FIGURA 64
NXËNËSIT - GJATË VITEVE TË FUNDIT AUTORITET PUBLIKE VENDORE A KANË ZBATUAR POLITIKA APO MASA EFEKTIVE KUNDËR KORRUPSIONIT NË SISTEMIN E EDUKIMIT?





FIGURA 65

STUDENTËT - GJATË VITEVE TË FUNDIT AUTORITET PUBLIKE VENDORE A KANË ZBATUAR POLITIKA APO MASA EFEKTIVE KUNDËR KORRUPSIONIT NË SISTEMIN E EDUKIMIT?




Mësimdhënësit poashtu janë pyetur se a pajtohen (në shkallë vlerësimi prej 1=aspak nuk pajtohem deri në 5=plotësisht pajtohem) me disa deklaratat, që kanë të bëjnë me politikat që do të duhej të ndërmerreshin për luftimin e korrupsionit tek institucionet arsimore.

Siç edhe shihet nga grafikoni i mëposhtëm, shumica e mësimdhënësve nga të gjitha komunat ku është zhvilluar hulumtimi, pajtohen me deklaratat e mëposhtme, ku më lartë të ranguar qëndrojnë deklaratat si: Mbrojtja e të drejtave të nxënësve përmes informimit, të drejtës për pjesëmarrje në vendimmarrje, të drejtës për të zgjedhur, të drejtës për të monitoruar menaxhmentin në lidhje me interesat e nxënësve dhe trajtim më i mirë dhe të ardhura personale më të mëdha, për mësimdhënësit e Arsimit të Mesëm të Lartë bazuar në të arriturat e tyre në mësimdhënie.

FIGURA 66


MËSIMDHËNËSIT - A PAJTOHENI ME KËTO DEKLARATA? RANGO PREJ 1 DERI NË 5 KU 1=ASPAK NUK PAJTOHEM DERI NË 5=PLOTËSISHT PAJTOHEM.



Në fund të pyetësorit kanë qenë të vendosura disa pyetje lidhur me përvojat personale që respondentët kanë pasur me korrupsion. Së pari mësimit të mesëm janë pyetur se në rast se u është dashur të japin para ose dhuratë shtesë, a i kanë lajmëruar institucionet përgjegjëse. Fillimisht shumica e mësimit të mesëm, ka theksuar se asnjëherë nuk kanë dhënë para ose dhuratë shtesë.

FIGURA 67

MËSIMDHËNËSIT - KUR IU ËSHTË DASHTË HERËN E FUNDIT TË JEPNI PARA APO DHURATË SHITESË NË SHKOLLËN TUAJ, A E KENI PARAQITUR KËTË PARA AUTORITETEVE/INSTITUCIONEVE ZYRTARE?



Një numër shumë i vogël ka pranuar (nga Komuna e Ferizajt), që ka pranuar dhuratë, dhe atë e ka lajmëruar tek Policia e Kosovës gjersa të tjerët nuk e kanë lajmëruar fare rastin për shkak se mendojnë që nuk i'a vlen ngase mund të dalin vetëm probleme. Ata mësimdhënës që e kanë lajmëruar rastin në Policinë e Kosovës, theksojnë se asnjë masë nuk është ndërmarrë më pas.

Në të njëjtën pyetje edhe shumica e nxënësve dhe studentëve, janë deklaruar se asnjëherë nuk kanë dhënë para apo dhuratë shtesë.

FIGURA 68

NXËNËSIT - KUR IU ËSHTË DASHTË HERËN E FUNDIT TË JEPNI PARA APO DHURATË SHITESË NË SHKOLLËN TUAJ, A E KENI PARAQITUR KËTË PARA AUTORITETEVE/INSTITUCIONEVE ZYRTARE?





FIGURA 69

STUDENTËT - KUR IU ËSHTË DASHTË HERËN E FUNDIT TË JEPNI PËRA APO DHURATË SHITESË NË SHKOLLËN TUAJ, A E KENI PARAQITUR KËTË PËRA AUTORITETEVE/INSTITUCIONEVE ZYRTARE?




Ata nxënës të cilët e kanë kryer një vepër të tillë dhe që kanë pranuar se i kanë njoftuar organet kompetente, kanë thënë se e kanë lajmëruar Policinë e Kosovës dhe në shumicën e rasteve procedura është nisur dhe më pastaj asgjë nuk është ndërmarrë. Sa i përket studentëve, një person që ka pranuar se ka lajmëruar organet kompetente, nuk ka dashur të ofrojë më shumë informata.

Nxënësit të cilët kanë pranuar se kanë dhënë para apo dhuratë shtesë, shumica prej tyre nuk i kanë lajmëruar organet kompetente që merren me rastet korruptive në arsim.

FIGURA 70

NXËNËSIT - ÇFARË KA NDODHUR PASI QË E KENI LAJMËRUAR RASTIN?



Si arsye pse nuk i kanë lajmëruar rastet e ngjashme të dhënies së parasë apo dhuratave shtesë, nxënësit dhe studentët që kanë kryer veprime të ngjashme theksojnë; se është praktikë e zakonshme të jepet para/dhuratë, frika nga pasojat, dobia nga dhurata apo edhe pse personi ka dhënë dhuratë në shenjë falënderimi.

FIGURA 71
NXËNËSIT - PSE NUK E KENI LAJMËRUAR?





FIGURA 72
STUDENTËT - PSE NUK E KENI LAJMËRUAR?



5. KONKLUZIONET

Rezultatet kanë shfaqur të dhëna shumë interesante dhe të dobishme të cilat e kanë bërë të mundur analizimin e hollësishëm dhe në mënyrë më specifike, të nxjerrin informata lidhur me perceptcionet, njohuritë dhe përvojat e mësimdhënësve, nxënësve dhe studentëve në raport me korrupsionin në sistemin e edukimit.

Nga rezultatet e dalta, vërehen shqetësime lidhur me problemet me të cilat ballafaqohet Kosova sot, ku sipas respondentëve (mësimdhënësve, nxënësve dhe studentëve) del që papunësia, korrupsioni dhe varfëria janë 3 probleme shumë sfiduese për Kosovën.

Sa i përket korrupsionit sipas respondentëve del që institucionet më të korruptuara janë Qeveria e Kosovës, Prokuroria e Kosovës, Gjykatat e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Partitë Politik dhe Universitetet Private dhe Publike. Është shqetësuese kur kemi parasysh që shumica prej institucioneve të lartpërmendura, janë edhe bartëse të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të proceseve shtetndërtuese.

Është interesant fakti se mësimdhënësit në shumicë, mendojnë se personat që janë të gatshëm të gënjejnë, mashtrojnë, nuk respektojnë ligjet dhe të korruptuarit, kanë më shumë gjasa të arrijnë në jetë se sa ata që nuk janë të tillë gjersa studentët dhe nxënësit kanë mendim tjetër dhe mendojnë se personat që janë të ndershëm, me nivel të lartë të integritetit, kanë më shumë gjasa të arrijnë në jetë se sa ata që nuk janë të tillë. Ndoshta këtu kemi edhe dallime gjeneratash pasi që nxënësit dhe studentët, janë ende të motivuar të shohin jetën prej perspektivës pozitive.

Shumica e respondentëve prej të tria grupeve të intervistuar, theksojnë se në institucione arsimore nuk ka shumë korrupsion siç ka në institucione tjera, por që ka nepotizëm, konkretisht pajtohen deri diku që stafi menaxherial i shkollës u jep përparësi anëtarëve të familjeve, të afërmeve dhe miqve të tyre, në rastin e pranimit të nxënësve në shkollë.

Është premtues fakti se një numër shumë i vogël i nxënësve/studentëve, kanë shfrytëzuar lidhjet e tyre, kanë paguar apo dhuruar diçka për të rregulluar ndonjë çështje në shkollë (nota, masa disiplinore, etj.) por është shqetësuese në anën tjetër se një numër bukur i madh i nxënësve, mendojnë se sjellje të tilla korruptive janë normale, duke përfshirë edhe nxënës që nuk kanë qenë akter në sjellje të tilla.

Nga rezultatet e nxjerra nga hulumtimi, ka dalë që ata të cilët kanë pranuar se kanë dhuruar dhuratat/para, në shumë raste nuk i kanë lajmëruar organet kompetente, për shkak se mendojnë që praktika të tilla korruptive janë normale, dobia nga dhuratat/shërbimi është e dyanshme dhe mendojnë se organet kompetente nuk i shkojnë rasteve deri në fund.

Si përfundim, situata në sistemin e edukimit në Kosovë sa i përket korrupsionit sipas perceptcioneve të marra nga mësimdhënësit, nxënësit dhe studentët, nuk është për t'u lënë anash, për shkak se sipas të dhënave, del që ka aktivitete korruptive, ka neglizhencë, nepotizëm, nga ana e stafit menaxherial të institucioneve arsimore dhe çka është më shqetësuese, është se praktika korruptive ka nga të gjitha palët (mësimdhënësit, stafi menaxherial, nxënësit, studentët) dhe që një numër i konsiderueshëm i tyre, i konsiderojnë sjellje të tilla korruptive si normale.

SHTOJCA I – MOSTRA FINALE E TARGET GRUPEVE TË INTERVISTUARA

ARSIMI I MESËM I LARTË - MOSTRA PËR NXËNËS TË SHKOLLAVE TË MESME

Numri i ndarë i nxënësve sipas shkollave	Mostra		
	Komuna	Totali i Mostrës	Shkolla Profesionale
Ferizaj	80	49	32
Mitrovicë	57	34	23
Podujevë	53	32	21
Prishtinë	150	72	78
Gjakovë	60	32	28
Totali	400	218	182

Mësimdhënësit/Arsimit të mesëm i lartë

Komuna	Mësimdhënëës
Ferizaj	22
Mitrovicë	16
Podujevë	10
Prishtinë	37
Gjakovë	15
Totali	100

Numri i ndarë i studentëve të Universitetit të Prishtinës

Fakulteti	Total
Fakulteti Filozofik	30
Fakulteti Filologjik	30
Fakulteti Juridik	30
Fakulteti Ekonomik	30
FSHMN	30
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	22
Fakulteti Teknik	22
Fakulteti i Mjekësisë	22
Fakulteti i Bujqësisë	22
Fakulteti i Edukimit	22
Fakulteti i Edukatës Fizike	22
Fakulteti i Arteve	18
Totali	300

Falënderimet

Publikimi i këtij hulumtimi u mundësua nga Programi i Angazhimit për Barazi (E4E), i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC.

Ky hulumtim është përgatitur nga stafi i Lëvizjes FOL. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Ndërsa, të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: www.levizjafol.org.

Rreth Lëvizjes FOL

Organizata është themeluar të mbështes qytetarin aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndërmarrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.



www.levizjafol.org | info@levizjafol.org
Rr. Andrea Gropa No.35 10000 Prishtinë – Kosovë